REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 296, Datë 20.10.2026

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 121, DATË 09.06.2025 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "GREEN ENERGY" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026, "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3099 prot., datë 16.10.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, *"Mbi plotësimin e kushteve të vendimit të licencimit në lidhje me depozitimin e informacionit të përditësuar për stafin teknik efektiv nga shoqëritë "Green Energy" sh.p.k. dhe "Solar Horizon" sh.p.k.",*

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "GREEN ENERGY" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 121, datë 09.06.2025, ka vendosur të licencojë shoqërinë "GREEN ENERGY" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30 vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar detyrimi që shoqëria *duhet të ndërtojë centralin dhe të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 01.06.2026,* ndërsa në pikën 3 është përcaktuar, ndër të tjera, që *me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe të përditësojë informacionin mbi strukturën organizative të saj, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar*. Shoqëria ka filluar veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në muajin maj 2026.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Sa i përket detyrimit për depozitimin e dokumentacionit të testimit të veprës, kjo çështje është trajtuar në vendimin unifikues të bordit të ERE-s nr. 295, datë 20.10.2026, ndaj vlerësimi i përmbushjes së këtij detyrimi nga shoqëria "GREEN ENERGY" sh.p.k. do të bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.
- Gjithashtu, rezulton se shoqëria "GREEN ENERGY" sh.p.k. ka filluar ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por nuk rezulton që të jetë përditësuar informacioni mbi strukturën organizative dhe stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar

brenda afatit prej 60 ditësh nga fillimi i aktivitetit, sipas detyrimeve të përcaktuara në vendimet e licencimit.

- Në këto kushte, duke qenë se detyrimi për përditësimin e informacionit për stafin teknik buron nga vendimi përkatës i bordit të ERE-s dhe centrali ka kaluar në fazën e shfrytëzimit, vlerësohet t'i lihet detyrë që, brenda datës 30.11.2026, të depozitojë informacion të përditësuar për stafin teknik efektiv.
- Duke qenë se shoqëria ka filluar tashmë ushtrimin faktik të veprimtarisë së licencuar të prodhimit të energjisë elektrike, vlerësohet e arsyeshme t'i jepet mundësia për të plotësuar dokumentacionin e munguar brenda një afati të përcaktuar, duke shmangur në këtë fazë marrjen e masave që do të cenonin vijimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.
- Në këtë kuadër, në rast të mosdepozitimit të dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar, ERE rezervon të drejtën të vendosë pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.
- Duke qenë se shoqëria "GREEN ENERGY" sh.p.k. ka filluar ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 121, datë 09.06.2025, detyrimi i parashikuar në këtë pikë rezulton i përmbushur. Në këto kushte, vlerësohet shfuqizimi i kësaj pike, duke qenë se detyrimi i përcaktuar në të është realizuar.
- Sa i përket detyrimit për dokumentimin e testimit të veprës, kjo çështje është trajtuar në konstatimet e këtij vendimi dhe në përputhje me përcaktimet e të cilit do të vlerësohet përmbushja e këtij detyrimi. Për këtë arsye, vlerësohet ndryshimi i pikës 3 të vendimit nr. 121, datë 09.06.2025, me këtë përmbajtje "*Brenda datës 30.11.2026, shoqëria "GREEN ENERGY" sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE informacion të përditësuar mbi strukturën organizative të saj, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar"*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 121, datë 09.06.2025, si vijon:

   a) Pika 2 e vendimit, shfuqizohet.

   b) Pika 3 e vendimit, ndryshon dhe bëhet:

   3. Brenda datës 30.11.2026, shoqëria "GREEN ENERGY" sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE informacion të përditësuar mbi strukturën organizative të saj, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar.

2. Në rast të mosdepozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi brenda

afatit të përcaktuar, ERE rezervon të drejtën të vendosë pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar për shoqërinë "GREEN ENERGY" sh.p.k, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "GREEN ENERGY" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI